

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6230
E mërkurë, 3 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

IKShPK-ja pranon
100 000 mijë teste
PCR, ShSKUK-ja 16
ventilatorë | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E MËRKURË) EDHE ZYRTARISHT FILLON FUSHATA ELEKTORALE
PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT | FAQE 4-5

NIS 'GJAHU' I PARTIVE PËR VOTA



Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit zyrtarisht fillon sot (e mërkurë). 28 subjektet politike të regjistruara në KQZ do të kenë mundësi që për 10 ditë t'i

shpalojnë programet e tyre dhe ta kërkojnë votën e qytetarëve për ditën e zgjedhjeve. Shoqëria civile u ka bërë thirrje partive politike që të largohen nga gjuha e urrejtjes dhe të zhvillojnë një

fushatë të qetë. Sipas tyre, qytetarët më shumë se kurrë kanë nevojë t'u ofrohen platforma të qarta politike në mënyrë që ata të marrin vendime mbi baza të programeve dhe ofertave politike


OPINION

PAS NËNTË VJETËVE LËNDA E
PARAQINIT ËSHTË DËSHMUAR
SE KA QENË MONTIM | F. 11

Shkruan:
Lulzim SAHITI



AKTUALE



OSMANI: NJOHJA NGA IZRAELI
KA FORCUAR POZICIONIN
NDËRKOMBËTAR TË KOSOVËS | F. 6

NË VITIN 2020 JANË
SEKUESTRUAR DHE KONFISKUAR
ASETE NË VLERË 1 MILION E 600
MIJË EURO | F. 6

EKONOMI



SHOQATA E EKSPORTUESVE
E KOSOVËS KËRKON KRIJIMIN
E FONDIT PËR EKSPORTET | F. 9

ARRIHET MARRËVESHJA PËR
PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT
TË MBETURINAVE | F. 9

SPORT

NUK LEJOHEN SHIKUESIT
NË 'FINAL 8' | F. 12



46 PËR QIND E QYTETARËVE
NUK KANË PËRDORUR
SHËRBIMET ELEKTRONIKE
GJATË PANDEMISË | FAQE 7

Rezultatet e një ankete nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kanë treguar se shpërthimi i pandemisë Covid-19 nuk ka ndryshuar dukshëm zakonet e qytetarëve të vendeve të

rajonit të Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë) kur bëhet fjalë për përdorimin e shërbimeve elektronike. Sa iu përket

qytetarëve të Kosovës, 46.5 për qind e qytetarëve të anketuar në Kosovë janë përgjigjur se nuk i kanë përdorur fare shërbimet elektronike pas shpërthimit të pandemisë

21 PROKURORË PRESIN
DEKRETIMIN E PËRHERSHËM

| FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Këtë vit SpaceX do ta dërgojë ekipin e parë civil në hapësirë

NJU-JORK, 2 SHKURT - Këtë vit kompania "SpaceX" do të dërgojë katër civilë në hapësirë. Ky do të jetë misioni i parë komercial në hapësirë. "SpaceX" ka njoftuar se anija kozmike e kompanisë do të komandohet nga Jared Isaacman, themeluesi dhe shef ekzekutiv i kompanisë private të përpunimit të pagesave "Shift4 Payments".

Biznesmeni miliardar amerikan do të dhurojë tri vende në kapsulën "SpaceX

Dragon" për qytetarë të tjerë. Siç thuhet, ata "do të zgjidhen për t'i përfaqësuar shtyllat e misionit të lidershit, shpresës, bujarisë dhe prosperitetit".

Biznesmeni Isaacman ka njoftuar se ai ka për qëllim ta përdorë udhëtimin privat për të mbledhur 200 milionë dollarë për St. Jude Children's Research Hospital. Ky institucion shëndetësor trajton kancerin dhe sëmundjet pediatrike. "Space X" ka njoftuar se



ekuipazhi do të niset në orbitën e Tokës diku në tremujorin e katërt të këtij viti nga Qendra Hapësinore Kennedy e NASA-s në Florida.

Para se të realizohet misioni, "SpaceX" do të ofrojë për udhëtarët trajnim astronaut si dhe të gatishmërisë emergjente. "Kur misioni përfundon udhëtimin në hapësirë, anija hapësinore do të hyjë përsëri në atmosferën e Tokës, duke bërë një ulje në brigjet e Floridas", ka njoftuar kompania "SpaceX".

ShBA-ja zotohet për mbështetje ushtarake dhe politike ndaj Ukrainës

UASHINGTON, 2 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka premtuar mbështetje të vazhdueshme për Ukrainën nga ana e administratës së re të presidentit Joe Biden. Në një bisedë telefonike me ministrin e Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, Blinken "theksoi mbështetjen e fuqishme për sovranitetin e Ukrainës, integritetin territorial dhe aspiratat e integritetit



euroatlantik. Ai u zotua se ShBA-ja do ta vazhdojë ndihmën e fuqishme ekonomike dhe ushtarake për Ukrainën", thuhet në njoftim e Departamentit të Shtetit, derisa është bërë me dije se Bideni po punon për një rezolutë diplomatike ndaj agresionit të Rusisë në Ukrainën lindore dhe Krime. Blinken, gjithashtu, i bëri thirrje Ukrainës ta mbajë ritmin në luftën kundër

korupsionit, zbatimin e sundimit të ligjit dhe reformat ekonomike. Dy shefat e diplomacisë diskutuan edhe për pandeminë e koronavirusit.

Ukraina është mbështetur në ndihmën dhe përkrahjen e ShBA-së kundër Rusisë qëkur Moska aneksoi në mënyrë të paligjshme Krimenë në vitin 2014 dhe mbështeti separatistët në Ukrainën lindore.

Erdogani: Turqia duhet të ketë një kushtetutë të re

Ankara, 2 shkurt - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka paralajmëruar se Turqia mund të miratojë një kushtetutë të re. Deklarata e tij ngjalli diskutime nëse ai përmes kësaj mase po synon zgjatjen e qeverisjes së tij.

Erdogan, 66 vjeç, ka qeverisur Turqinë si kryeministër ose president që nga viti 2002, duke forcuar kontrollin e tij mbi kombin me 83 milionë banorë, si dhe duke i mbijetuar një grusht shteti të dështuar.

Më 2017 Turqia ndryshoi

Kushtetutën duke i siguruar presidentit më shumë fuqi ekzekutive dhe duke e zbehur fuqinë e pozitës së kryeministrit. Ai më pas fitoi zgjedhjet presidenciale më 2018. Ky është mandati i parë nga dy mandatet e mundshme pesëvjeçare sipas rregullave. Zgjedhjet në Turqi janë planifikuar të mbahen në qershor të vitit 2023, që do të thotë se nëse ai rizgjidhet, qeverisja e tij do të duhet të mbarojë deri në vitin 2028.

Por, pasi kryesoi një takim kabineti katërorësh,

presidenti ngriti idenë për të shkruar një Kushtetutë krejt të re për të zëvendësuar atë që Turqia ka përdorur që nga viti 1982. Ajo u hartua pas një grushtshteti ushtarak. "Është e qartë se burimi i problemeve të Turqisë është se kushtetutat janë shkruar gjithmonë nga puçistë. Nëse arrijmë një mirëkuptim të përbashkët me partnerët tanë (koalicionin qeverisës), ne mund të marrim masa për një Kushtetutë të re në të ardhmen", ka thënë Erdogan në televizionin kombëtar.



Në Londër po bëhen testime masive për t'i izoluar vatrat




Londër, 2 shkurt - Në Britani ka filluar testimi i 80 mijë personave për variantin jugoafrikan të koronavirusit, i cili duket se po përhapet në komunitetet. Testimet kanë filluar edhe në tri zona të Londrës, dy prej të cilave me një përqendrim të madh të komunitetit shqiptar. Autoritetet në Londër kanë

kërkuar që banorët e këtyre zonave të mendohen dy herë kur të dalin nga shtëpitë, qoftë edhe për arsye të esenciale. Zyrtarët e shëndetësisë, policia, zjarrfikësit janë duke u përfshirë në fushatën për testimin dhe gjurmimin e personave që mund të jenë të infektuar me variantin jugoafrikan të koronavirusit.

Në Britani është raportuar një shifër prej 105 vetave me këtë variant korone, por pas zbulimit të 11 rasave të reja te njerëzit që nuk kanë pasur histori udhëtimesh ndërkombëtare, ekziston frika se këto shifra mund të shkojnë në disa mijëra vetë, në një përhapje më të madhe se çmendohej në komunitet.

Osmani: Njohja nga Izraeli ka forcuar pozicionin ndërkombëtar të Kosovës



PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, i ka thënë të martën homologut izraelit, Yariv Levin, se pas njohjes së shtetësisë së Kosovës nga ana e Izraelit, të dyja këto shtete do të kenë mundësi ta rrisin bashkëpunimin në shumë fusha. Për Osmanin, lidhjet e Kosovës

me Izraelin janë të rëndësishë strategjike. Në bisedën telefonike me Levinin, Osmani është cituar të ketë thënë se beson që njohja e Izraelit ka forcuar pozicionin e Kosovës në skenën ndërkombëtare dhe shpreson që edhe vendet e tjera mosnjohëse të veprojnë njëjtë. Në një komunikatë për media të Presidencës, është thënë se dy

zyrtarët kanë diskutuar edhe për antisemitizmin. "Antisemitizmi nuk ka gjetur vend në Kosovë. Në këtë plan ne do të punojmë edhe me rininë e Kosovës lidhur me edukimin e tyre për luftën kundër antisemitizmit", është cituar të ketë thënë Osmani. Levin, në anën tjetër, ka fituar Osmanin për vizitë në Izrael në të ardhmen. Kosova dhe Izraeli kanë

formalizuar marrëdhëniet diplomatike më 1 shkurt. Në një ceremoni virtuale të mbajtur të hënën, ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla dhe ministri i Punëve të Jashtme i Izraelit, Gabriel Ashkenazi, kanë nënshkruar dokumentin në të cilin thuhet se të dyja shtetet vendosin marrëdhënie

diplomatike me qëllim që ta rrisin bashkëpunimin në shumë sfera. Ministri izraelit, Ashkenazi, ka thënë se të dyja shtetet po bëjnë histori. Shtetet e Bashkuara e kanë mirëpritur këtë lajm, derisa Bashkimi Evropian e ka konsideruar fatkeq vendimin e Kosovës për hapje të Ambasadës së Kosovës në Jerusalem.

Bashkëpunim në mes të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Avokatit të Shtetit

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, Sami Istrefi, të martën është pritur në takim nga Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Naim Qelaj. Në këtë takim Istrefi e ka njoftuar Qelajn me punën dhe aktivitetet e Avokaturës Shtetërore si dhe me sfidat me të cilat po ballafaqohet ky institucion. Gjatë takimit, me theks të veçantë u diskutua për rastet në gjykatat e rregullta si dhe ato në Tribunalin e Arbitrazhit Ndërkombëtar me të cilat Avokatura Shtetërore është duke punuar në vazhdimësi me këto raste. Nga ana tjetër, Qelaj ka përgëzuar Istrefin për përpunimin që ka arritur Avokatura Shtetërore, duke

theksuar rolin shumë të rëndësishëm që ky institucion ka për Republikën e Kosovës. Qelaj ka theksuar se duke marrë parasysh veprimtarinë dhe mandatin kushtetues të institucionit të Avokatit të Popullit, mbetet i përkushtuar për të përkrahur çdo iniciativë e cila do ta ndihmonte edhe më tej përpunimin e AVSh-së ngaqë, sipas tij, Avokatura Shtetërore duhet të jetë një nga institucionet më të rëndësishme në shtet. Avokati Istrefi e ka falënderuar Qelajn për bashkëpunimin e ofruar duke vlerësuar njëherësh punën dhe angazhimin që ky institucion i pavarur bën për mbrojtjen e të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.





SOT (E MËRKURË) EDHE ZYRTARISHT FILLON FUSHATA ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT

Nis 'gjahu' i partive për vota

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit zyrtarisht fillon sot (e mërkurë). 28 subjektet politike të regjistruara në KQZ do të kenë mundësi që për 10 ditë t'i shpalosin programet e tyre dhe ta kërkojnë votën e qytetarëve për ditën e zgjedhjeve. Shoqëria civile u ka bërë thirrje partive politike që të largohen nga gjuha e urrejtjes dhe të zhvillojnë një fushatë të qetë. Sipas tyre, qytetarët më shumë se kurrë kanë nevojë t'u ofrohen platforma të qarta politike në mënyrë që ata të marrin vendime mbi baza të programeve dhe ofertave politike

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 SHKURT - Partitë politike nga sot (e mërkurë) edhe zyrtarisht do ta nisin garën për mbledhjen e votave për 14 shkurt. 28 subjekte politike të regjistruara në KQZ do të kenë në dispozicion 10 ditë fushatë zgjedhore për t'i bindur qytetarët e Kosovës që të votojnë për programet e tyre ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, aktivitetet e tyre elektorale partitë i kanë filluar që nga shpallja e datës së zgjedhjeve. Gjatë kësaj kohe, përveç prezantimit të listave për deputetë, ato kanë prezantuar sloganet dhe pjesë të

programeve të tyre.

Lëvizja Vetëvendosje në këto zgjedhje do të garojë me sloganin "Krejt dhe drejt", Partia Demokratike e Kosovës me "Rimëkëmbje", Lidhja Demokratike e Kosovës me "Shteti. Shtet", Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me "Forca e Kosovës" dhe Nisma Socialdemokrate me "Me çlirimtarët!".

Në prag të fillimit të fushatës zgjedhore, shoqëria civile u ka bërë thirrje partive politike që të largohen nga gjuha e urrejtjes dhe të zhvillojnë një fushatë të qetë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga partitë politike që

të krijohen kushtet e barabarta për fushatë, si për kandidatët ashtu edhe për parti politike. "Lëreni anash gjuhën e urrejtjes dhe krijoni kushte për fushatë jodiskriminuese sikur edhe zgjedhje të rregullta. Lëri folklorin dhe lejoni që votuesi, me votën e vet, ta dënojë apo ta përkrahë një kandidat të preferuar apo subjekt të caktuar politik. Çdo veprim tjetër është dhunë dhe presion e që duhet të refuzohet nga të gjithë", ka vlerësuar KMDLNj-ja.

Të njëjtën thirrje e ka bërë edhe koalicioni i Organizatave Joqeveritare Demokratia në Veprim (DnV). Eugen Cakolli, teksa ka shpalosur planin e

DnV-së për monitorimin e fushatës për zgjedhjet e 14 shkurtit, ka thënë se partitë politike duhet të bëjnë fushatë të qetë dhe në frymë konkurruese. "Duke qenë se rregullativa zgjedhore kërkon që fushata zgjedhore të zhvillohet mbi premisat e një gare të barabartë dhe duke shmangur gjuhën denigruese, DnV kërkon që gara zgjedhore të zhvillohet në frymë të qetë dhe që në thelb të jetë konkurruese", ka thënë Cakolli, duke shtuar se është e nevojshme që qytetarët t'i shohin ofertat dhe programet e partive politike. "Qytetarët më shumë se kurrë kanë nevojë t'u ofrohen platforma të qarta politike në mënyrë që ata të marrin vendime mbi baza të programeve dhe ofertave politike. Duke u mishëruar me këto oferta në këtë fazë, qytetarët do të jenë më të prirë të kërkojnë llogaridhënie për implementimin e këtyre programeve", ka thënë ai. KMDLNj-ja dhe DnV-ja kanë përmendur incidentet e ndodhura së fundmi në Mitrovicë dhe Skenderaj. "KMDLNj ua përkujton të gjithëve se vlerësimin për shkallën e rrezikut në Kosovë

apo në një pjesë të saj e bëjnë institucionet e specializuara të sigurisë, që nxjerrin vendime, kurse Policia e Kosovës i zbaton ato vendime. Edhe në rastin e Mitrovicës si dhe të Skenderajt, veprimet e Policisë së Kosovës janë në përputhje të plotë me ligjin", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Edhe për DnV-në këto incidente janë të papranueshme. "Incidentet e raportuara gjatë vizitës së u. d. të presidentit, Vjosa Osmani dhe Albin Kurtit, si kandidat për kryeministër nga radhët e LV-së, në pjesën veriore të vendit dhe në Komunën e Mitrovicës së Jugut, si dhe gjatë vizitës së djeshme e këtij të fundit në Komunën e Skenderajt, DnV i vlerëson këto incidente si krejt të papranueshme dhe të dënueshme, dhe rithekson që të gjitha subjektet politike, pavarësisht etnisë apo orientimit politik, kanë të drejtën e lëvizjes së lirë dhe bërjes fushatë në çdo pjesë të vendit. Prandaj, duhet që qytetarët të përmbahen nga çfarëdo veprimi i dhunës që mund ta pengojë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor", ka deklaruar Eugen Cakolli nga DnV-ja.

Partitë t'i respektojnë masat kundër Covidit

Në aktivitet e tyre të deritashme elektorale, partitë politike nuk kanë respektuar masat kundër Covidit. Në tubimet e tyre është parë numër i madh i njerëzve pa maska dhe pa e mbajtur distancën e nevojshme. Këto veprime të subjekteve politike janë kritikuar nga shoqëria civile. Organizata të ndryshme të shoqërisë civile u kanë bërë thirrje partive politike që gjatë fushatës zgjedhore të respektohen këto rregulla. "Vërejtja kryesore e KMDLNJ-

së në këtë fazë është mungesa totale e respektimit të kushteve kundër Covidit e që është përcaktuar nga institucionet kompetente shëndetësore dhe shtetërore të Kosovës sikur që janë: vendosja e maskës mbrojtëse, mbajtja e distancës fizike, mosgrumbullimi i shumë njerëzve në hapësira të ngushta dhe të papërshtatshme", ka vlerësuar KMDLNJ, duke ftuar autoritetet të marrin masa ndaj partive politike. "Në këtë kontekst, autoritetet duhet të jenë shumë në të rrepta për shqiptimin e masave ndëshkuese për të gjithë shkelësit, pa bërë asnjë

përjashtim dhe pa zbatuar standarde të dyfishta", ka vlerësuar ky këshill.

DnV ka kërkuar që gjatë fushatës të mos rrezikohen qytetarët. "DnV ka evidentuar shumë aktivitete zgjedhore të cilat janë zhvilluar pa përfilljen e masave anti-Covid, gjë që përbën rrezik për shëndetin e qytetarëve. Prandaj, DnV kërkon nga subjektet politike t'i respektojnë kufizimet mbi numrin e pjesëmarrësve në tubime, si dhe ta konsiderojnë përdorimin e teknologjisë informative për zhvillimin 'online' të fushatës për aq sa është e mundur", ka thënë

Eugen Cakolli nga DnV-ja. Sipas tij, të gjitha komunat duhet të veprojnë sikurse Komuna e Prishtinës duke i dënuar partitë politike që nuk i respektojnë këto masa. "Ndërsa nga institucionet përkatëse, sidomos ato të nivelit lokal, u kërkuar të ndiqet shembulli i Komunës së Prishtinës dhe të shqiptohen gjopa ndaj të gjitha subjekteve politike në rast të mosrespektimit të masave kundër përhapjes së Covid-19. Amnistimi i partive politike për mosrespektim të masave mund të kushtojë me rritje të infeksioneve, mbingarkesë të shërbimeve shëndetësore e

humbje të jetëve", është shprehur ai.

Në zgjedhjet e 14 shkurtit do të marrin pjesë 21 parti politike, dy koalicione parazgjedhore dhe pesë iniciativa qytetare. KQZ-ja ka bërë me dije se numri i përgjithshëm i kandidatëve për këto zgjedhje është 1 079. Një ditë më parë është bërë edhe tërheqja e numrave për renditjen e partive politike në fletëvotim. LV-ja do të garojë me numrin 127, LDK-ja me numrin 132, PDK-ja me numrin 134, AAK-ja me numrin 135 dhe Nisma me numrin 121.

Policia me plan operativ për zgjedhjet e 14 shkurtit

Policia e Kosovës përmes hartimit të urdhrimit operativ policor ka bërë të gjitha planifikimet lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat do të mbahen më 14 shkurt.

Policia ka njoftuar se me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor janë bashkërenduar dhe koordinuar aktivitetet e përbashkëta me Prokurorinë e Shtetit dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përderisa në aspektin policor do të angazhohen një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policorë të profileve të ndryshme që iu përkasin njësiteve të ndryshme brenda Policisë së Kosovës.

"Planifikimi operativ ka

paraparë implementimin dhe realizimin e planit policor në katër faza, duke filluar nga: 1) Periudha parazgjedhore apo përgatitore vlerësuese; 2) Angazhimi në ofrimin e sigurisë gjatë fushatës zgjedhore; 3) Garantimi i sigurisë në fazën kyçe të ditës së zgjedhjeve dita (Z); 4) Periudha pas zgjedhjeve që parashihet transportin nën përcjellje dhe siguri të PK-së, të materialit sensitiv e deri në përfundim të procesit", është thënë në njoftimin e policisë. Sipas planifikimeve policore, qëllimi i këtij urdhri operativ për këtë proces zgjedhor është: Krijimi i një klime të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe mbajtja e rendit, qetësisë dhe

sigurisë publike në vend para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve, gjithnjë duke zbatuar edhe (Ligjin nr. 07/L-006) për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në tërë territorin e Republikës së Kosovës, vendimet e Qeverisë së RKS-së, vendimet dhe qarkoret e Ministrisë së Shëndetësisë si dhe rekomandimet e IKShP-së.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka marrë masa shtesë duke caktuar edhe koordinatorë të Policisë me KQZ-në dhe institucionet e tjera të angazhuara në këtë proces, si dhe hartimin e një udhëzuesi për zyrtarët policorë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore gjatë procesit zgjedhor.

IKShPK-ja kërkon ndalimin e tubimeve të partive politike

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKShPK) ka kërkuar zbatimin e masave kundër Covidit, sidomos tash që është paraqitur edhe varianti i ri i virusit SARS CoV-2. IKShPK-ja përmes një komunikate ka bërë pesë rekomandime e gati të gjitha prekin më së shumti partitë politike, që tash e disa javë po organizojnë tubime të mëdha me simpatizantë në hapësira të mbyllura. Në pikën e tretë, IKShPK-ja ka rekomanduar "ndalimin rigoroz të tubimeve, sipas vendimeve në fuqi". "Grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe pa mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit, përderisa virusi SARS-COV-2 është në mesin tonë. Apelojmë

tek institucionet përgjegjëse, përkatësisht Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse, që të mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi për zbatim të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës", është thënë në komunikatën e IKShPK-së.

Nga sot (e mërkurë) pritet të shpeshohen tubimet politike, pasi nis fushata zgjedhore për zgjedhjet e 14 shkurtit. Deri më tash, vetëm Inspektorati në Komunën e Prishtinës i ka gjobitur partitë politike, në tetë raste, për shkelje të masave kundër Covidit.

Në zgjedhjet e 14 shkurtit, 143 mijë e 6 votues më pak se në zgjedhjet e 2019-s

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve brenda dhe jashtë Kosovës për zgjedhjet e 14 shkurtit.

Sipas KQZ-së, numri i votuesve brenda Kosovës është 1 milion e 794 mijë e 862 votues, apo 143 mijë e 6 votues më pak se në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019.

Arsyeja se pse ka më pak votues në këto zgjedhje është për shkak se KQZ-ja ka vendosur që t'i largojë nga lista votuese 122 mijë e 421 persona të cilët

posedojnë vetëm dokumente të identifikimit të lëshuar nga UNMIK-u.

Sipas KQZ-së, dokumentet e UNMIK-ut nuk shërbejnë për t'u identifikuar në vendvotim në ditën e zgjedhjeve.

Po ashtu, KQZ-ja ka larguar nga lista votuese edhe 11 mijë e 86 persona të cilët janë konfirmuar se janë larguar nga skema pensionale për shkak se kanë vdekur.

Numri i Qendrave të Votimit në të gjithë Kosovën është 888, me gjithsej 2 mijë e 382 vendvotime.

Votimi nga diaspora, edhe qytetarët që nuk kanë pranuar telefonatë nga KQZ-ja mund të votojnë

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka thënë se të gjitha e-mail që janë dërguar nga diaspora janë hapur, dhe se kanë telefonuar mbi 80 mijë qytetarë në diasporë. Daka ka thënë se pavarësisht që nuk kanë arritur të telefonojnë të gjithë votuesit, ata prapë do të kenë të drejtë të votojnë. "Të gjithë ata që kanë dokumentuar zotësinë juridike të tyre, pra kanë bashkangjitur dokumentacionet që

janë verifikuar nga shërbimi i listës së votuesve, janë përfshirë në listën përfundimtare të votuesve, dhe do të kenë të drejtë të votojnë pas pak çastesh. Askujt nuk do t'i mohohet e drejta kushtetuese. Edhe pse nuk kemi mundur t'i thërrasim të gjithë, ata prapë do të mund të votojnë", ka deklaruar ajo. Sipas të dhënave të KQZ-së, numri i personave që janë regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës është 102 mijë e 100.



Në vitin 2020 janë sekuestruar dhe konfiskuar asete në vlerë 1 milion e 600 mijë euro

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Ministri në detyrë i Drejtësisë, Selim Selimi, së bashku me drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK), Kushtrim Cukaj dhe zëvendëssekretarin Ardian Bajraktari, kanë vizituar Depon Qendrore për Mallrat e Konfiskuara. Gjatë kësaj vizite Selimi tha është njoftuar për së afërmi me kapacitetet e kësaj depoje e cila ka për qëllim administrimin më efikas të pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara. "Sot vizituar depon e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, për ta parë nga afër gjendjen aktuale dhe kapacitetet e saj. Vetëm në vitin 2020 vlera e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara ka arritur rreth një milion e gjashtëqind mijë euro", tha Selimi. Sipas tij,

konfiskimi i pasurisë së paligjshme mbetet prioritet dhe mekanizëm kryesor për luftim të suksesshëm kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Çdokush që tenton të përfitojë jashtëligjshëm do të jetë cak i hetimit dhe askush nuk do të jetë mbi ligjin. Shteti nuk do të ndalet së sekuestruari dhe konfiskuari çdo pasuri që fitohet në mënyrë të paligjshme", tha Selimi. Ministri Selimi tha se duhet rregulluar infrastruktura e nevojshme në depon e AAPSK-së në mënyrë që të rritet kapaciteti i konfiskimit. "Ministria e Drejtësisë do të bëjë çdo gjë që është e mundur që t'i shtojë kapacitetet për ta rregulluar infrastrukturën e nevojshme sa i përket kësaj depo, në mënyrë që Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Administrimin e Pasurisë së



Konfiskuar dhe të Sekuestruar të jenë të gatshëm që kur të rritet kapaciteti i konfiskimit si rezultat i ndryshimeve ligjore, t'i administrojnë pasuritë e konfiskuara edhe të

sekuestruara në pajtim me legjislacionin në fuqi", shtoi Selimi. Ndryshe nga periudha kohore qershor - dhjetor 2020, Agjencia për Administrimin e

Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ka ekzekutuar gjithsej 92 vendime të dërguara nga gjykatat për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

IKShPK-ja pranon 100 000 mijë teste PCR, ShSKUK-ja 16 ventilatorë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se MSh i ka dorëzuar të martën 100 000 teste PCR në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, për t'i forcuar kapacitetet e testimeve dhe për ta vazhduar testimin në masë, pas fillimit të testimeve edhe në Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike.

Gjithashtu, edhe 16 ventilatorë i janë dorëzuar Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. "Ashtu siç kemi premtuar, sot i kemi dorëzuar edhe 16 ventilatorë të tjerë Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për t'i shtuar kapacitetet e trajtimit klinik të pacientëve. Përkushtimi ynë është që mungesa e testeve të mos jetë asnjëherë temë e punës së profesionistëve tanë shëndetësorë dhe përmes rritjes së kapaciteteve të lehtësohet



identifikimi i kontakteve të rasteve pozitive dhe të zhvillohet gjurmimi dhe hulumtimi epidemiologjik për ta izoluar sa më shumë virusin", ka thënë ministri Zemaj.

Testet e dorëzuara në IKShPK dhe ventilatorët për ShSKUK-në, theksoi ai, janë blerë nga Ministria e Shëndetësisë përmes Projektit të Shëndetësisë së Kosovës

(huamarrja nga Banka Botërore), ndërsa janë siguruar përmes shërbimeve të prokurimit të UNOPS-it. "Në stoqet e IKShPK-së ka teste të mjaftueshme PCR për

detektimin e SARS-COV 2, prandaj u bëjmë sërish thirrje qytetarëve nga të gjitha regjionet që të testohen", bëri thirrje ministri Zemaj. Ai ka qëndruar të martën edhe në Klinikën Infektive të QKUK-së për t'u uruar specialistëve të Infektologjisë dhe të Radiologjisë fillimin e shkollimit specialistik, të ndarë për ta nga Ministria e Shëndetësisë. "Armatës së ekipit të mrekullueshëm të infektologëve dhe radiologëve sot iu shtuan edhe specialistët e rinj. Tashmë në Klinikën Infektive shkollimin specialistik janë duke e kryer 17 mjekë, ndërsa në Klinikën Radiologjike 42. Specialistët do ta vazhdojnë shkollimin, ndërsa neve, bartësve të përgjegjësive institucionale, na mbetet të përgëzojmë kuadrin tonë për specializim si dhe specialistët e rinj, si e ardhmja e shëndetësisë tonë, duke qenë edhe dëshmitarë, edhe kontribuues të kësaj të arritje", ka thënë ministri Zemaj.

Kosova regjistron tri viktima dhe 245 të infektuar me Covid gjatë 24 orëve

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të martën 245 persona të infektuar me Covid-19, pas testimit të 2 615 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se në 24 orët e fundit

janë regjistruar tri viktima me këtë virus. "Rastet e vdekjes janë nga komunat: Mitrovicë një rast (64 vjeç), Podujevë një rast (76 vjeç) dhe Suharekë një rast (62 vjeç)", është thënë në njoftimin e këtij instituti. Sipas IKShPK-së, nga Covid-19 të martën janë shëruar edhe 189

persona, derisa raste aktive janë 6 429. Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me Covid-19 në Kosovë, autoritetet shëndetësore në këtë shtet kanë regjistruar 60 745 persona të infektuar me këtë virus. Prej tyre, 1 506 pacientë kanë vdekur.



46 për qind e qytetarëve nuk kanë përdorur shërbimet elektronike gjatë pandemisë

Rezultatet e një ankete nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kanë treguar që shpërthimi i pandemisë Covid-19 nuk ka ndryshuar dukshëm zakonet e qytetarëve të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë) kur bëhet fjalë për përdorimin e shërbimeve elektronike. Sa i përket qytetarëve të Kosovës, 46.5 për qind e qytetarëve të anketuar në Kosovë janë përgjigjur se nuk i kanë përdorur fare shërbimet elektronike pas shpërthimit të pandemisë



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Rezultatet e një ankete kanë treguar që shpërthimi i pandemisë Covid-19 nuk ka ndryshuar dukshëm zakonet e qytetarëve të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë) kur bëhet fjalë për përdorimin e shërbimeve elektronike.

Rëndësia e shërbimeve elektronike - cilësia dhe mundësia e arritjes së tyre për qytetarët - u bë veçanërisht e rëndësishme në periudhën kur pandemia ishte në kulmin e saj, sepse kontakti fizik me administratën u zvogëluar në minimum. Sidoqoftë, rezultatet e hulumtimit treguan se pandemia nuk kishte ndikuar që qytetarët në rajonin tonë të fillojnë t'i përdorin shërbimet elektronike më shpesh. Sipas një komunikate për media nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), anketa u krye nga 1 deri më 15 maj 2020, me një mostër prej 6 085 qytetarëve

të vendeve të rajonit, ndërsa nga Kosova ishin 1 021 qytetarë. Kjo anketë është bërë në kuadër të projektit WeBER 2.0 (Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar). "Rezultatet tregojnë se vetëm 18 për qind e qytetarëve të rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë përdorur shërbimet elektronike më shumë se zakonisht gjatë pandemisë dhe se rreth 50 për qind e të anketuarve nuk kanë përdorur fare këtë lloj shërbimi në atë periudhë. Mesatarisht, dy të tretat e qytetarëve të rajonit thonë se interesi i tyre në shërbimet elektronike nuk është rritur që nga fillimi i pandemisë. Sa i përket qytetarëve të Kosovës, vetëm 23.90 për qind e të anketuarve janë interesuar më shumë për përdorimin e shërbimeve elektronike pas shpërthimit të pandemisë. Megjithatë, 46.5 për qind e qytetarëve të anketuar në Kosovë janë përgjigjur se nuk i kanë përdorur fare shërbimet elektronike që ofron administrata publike përgjatë krizës pandemike", thuhet në

këtë komunikatë të GLPS-së.

Rezultatet tregojnë që qytetarët të cilët janë të informuar se si t'i përdorin shërbimet elektronike thonë se ky lloj shërbimi është i lehtë për t'u përdorur dhe ishin më të interesuar për përdorimin e tyre, ndërsa qytetarët që nuk dinë shumë për to nuk ishin të prirë t'i përdorin ato gjatë pandemie. Këto rezultate mund të shpjegohen me mungesën e informacionit si dhe me faktin se qytetarët nuk janë mjaft të trajnuar për t'i përdorur shërbimet elektronike, ose me faktin se shumica e qytetarëve kanë nevojë për më shumë kohë për t'u mësuar të ndërveprojnë me administratën publike. "Ka shumë të ngjarë që të jetë një kombinim i këtyre dy faktorëve; mungesa e njohurive e kombinuar me zakonet e vjetra është ajo që parandalon shumë njerëz të mbështeten në

ndërveprimin elektronik me administratën. Rreth 40 për qind e qytetarëve të rajonit të Ballkanit Perëndimor preferojnë kontaktet fizike dhe, pavarësisht nga pandemia, ata nuk kanë qenë të interesuar për përdorimin e shërbimeve elektronike. Rezultatet e hulumtimit tregojnë gjithashtu se në mesin e grupit më të ri të të anketuarve në të gjithë rajonin, të moshës 18 deri 24 vjeç, ka interes më të madh për përdorimin e shërbimeve elektronike. Sidoqoftë, ai interes zvogëlohet me moshën, pastaj fillon të rritet, kështu që kategoria e dytë që është më e interesuar për shërbimet elektronike është grupi i qytetarëve që janë më të vjetër se 60 vjeç", theksohet në këtë komunikatë.

Sipas GLPS-së, qytetarët në të gjitha vendet e rajonit të

Ballkanit Perëndimor në përgjithësi kanë qasje të rezervuar në përdorimin e shërbimeve elektronike e që kjo nuk ndryshoi as gjatë pandemisë. Fushatat më proaktive të informacionit nga qeveritë janë të nevojshme në mënyrë që qytetarët të jenë më të vetëdijshëm, në radhë të parë për ekzistencën e shërbimeve elektronike, pastaj me faktin që kjo është mënyra për ta marrë shërbimin e dëshiruar më shpejt dhe më lehtë sesa do të arrinin duke shkuar fizikisht në sportelet e administratës. "Kjo, në kombinim me ngritjen e nivelit të cilësisë së këtij lloji të shërbimeve, siguron se do të çojë në atë se qytetarët ndiejnë më shumë besim dhe e përdorin më shumë këtë lloj shërbimi, si në rrethana normale, ashtu edhe të jashtëzakonshme", thuhet në komunikatën e GLPS-së.

21 prokurorë presin dekretimin e përhershëm

PRISHTINË, 2 SHKURT - Nga 22 janari i këtij viti 21 prokurorë të Kosovës u ka skaduar mandati fillestar prej tre vjetësh. Ndonëse pa riemërim nga presidenti, ata janë duke e vazhduar punën normalisht.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka konfirmuar vlerësimin pozitiv për vazhdimin e punës së tyre, por ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ende nuk e ka bërë riemërimin apo dekretimin e përhershëm të tyre. Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk ka mundur të tregojë nëse këta prokurorë kanë mandat për të punuar pa dekretim të presidentit. "Këta janë prokurorë që janë dekretuar një herë, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka konfirmuar vlerësimet pozitive për ta dhe, bazuar në këtë, pritet që në ditët në vijim të kemi konfirmimin e dekretimit të përhershëm", ka bërë me dije



Zyra për Informim e Këshillit Prokurorial të Kosovës për gazetën "Epoka e re".

Kurse një prokuror në kushte anonimi ka thënë për gazetën se janë të shqetësuar për zvarritjen

e riemërimin të tyre. "Nga data 22 janar jemi pa dekret, në të njëjtën kohë po vazhdojmë punët sipas

detyrës zyrtare. Mosriemërimi natyrisht se na shqetëson në kryerjen e punës sonë", ka thënë një nga këta prokuror.

Sipas Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, presidenti i Kosovës emëron dhe riemëron prokurorët. "1. Presidenti emëron dhe riemëron prokurorët bazuar në propozimet e Këshillit; 2. Presidenti, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati presidenti nuk e emëron prokurorin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj presidenti emëron prokurorin sipas propozimit të Këshillit", thuhet në nenin 23 të këtij ligji.

Arrihet marrëveshja për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) dhe Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) kanë nënshkruar të martën marrëveshjen për realizimin e projektit për bashkëpunim teknik me katër komuna, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave, vlera e të cilit është 2.8 milionë euro.

Nënshkrimi u bë nga sekretari i MEA-së, Fatos Qërimi dhe zëvendësfaqësuesi i JICA-s për Ballkan, Hibio Takashi. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes të pranishëm ishin ministri i MEA-së, Muharrem Nitaj dhe ambasadori i Japonisë në Republikën e Kosovës, Mitsunori Ogasawara. Ministri i MEA-s, Muharrem Nitaj, ka thënë me këtë rast se

kjo nuk është ndihma e parë e qeverisë japoneze dhe kjo është një marrëveshje e nevojshme për qytetarët e Kosovës. "Sot Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka nënshkruar një marrëveshje me rëndësi me Agjencinë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA), një projekt ky prej 2.8 milionë eurosh, që ndihmon për trajtimin e mbetjeve në katër komuna të rajonit të

Prizrenit. Kjo nuk është ndihma e parë e qeverisë japoneze, e popullit japonez. Ne kemi pasur fat gjithmonë që na u kanë gjendur pranë", u shpreh Nitaj. Ambasadori i Japonisë në Republikën e Kosovës, Mitsunori Ogasawara, ka thënë se kjo është një marrëveshje e ndihmës teknike në mes të Qeverisë së Japonisë dhe Qeverisë së Kosovës. "Kjo marrëveshje ka të bëjë me

ndihmë teknike. Në nëntorin e kaluar kemi dhuruar 15 kamionë për mbledhjen e mbeturinave për regjionin e Prizrenit. Shpresoj se ekspertët japonezë ta vizitojnë së shpejti Kosovën dhe të bashkëpunojnë me popullin e Kosovës", u shpreh ai. Projekti fillon të realizohet në muajin maj dhe përfshin komunat Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Rahovec.



Dy projekte të reja infrastrukturore për Istogun

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Ministri në detyrë i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka nënshkruar memorandum me kryetarin e Komunës së Istogut, Haki Rugova, për financimin e disa projekteve infrastrukturore në këtë komunë. Abrashi ka thënë se në Komunën e Istogut, Ministria e Infrastrukturës do të investojë në dy projekte infrastrukturore, në vlerë gjysmë milioni euro, që

do të shërbejnë për kompletimin e infrastrukturës së kësaj komune. Rregullimi i rrugës në qendër - Gurrakoc, vlera 207 mijë euro dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore te burimi i Istogut, në vlerë prej 290 mijë eurosh, janë dy projekte që do të realizohen në Istog. Ministria e Infrastrukturës ka paraparë në të gjitha komunat projekte të reja për vitin 2021.



Gjenden radarët që ishin vjedhur në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës ka njoftuar se janë gjetur pajisjet mekanike të radarëve civilë që ishte

raportuar se janë vjedhur. Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës, pajisjet ishin ngarkuar gabimisht në një kompani tjetër dhe pas

verifikimit të depos, është parë se nuk mungon asgjë dhe pajisjet janë u janë dorëzuar zyrtarëve përkatës. "Në konsultim me

prokurorin janë intervistuar gjashtë persona në cilësi të dëshmitarëve", thuhet në njoftimin e policisë.



Shoqata e Eksportuesve e Kosovës kërkon krijimin e fondit për eksportet

Kryetari i Shoqatës i Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta krijojë një fond të veçantë për eksportuesit meqenëse, sipas tij, eksportuesit po përballen me gjendje të rënduar financiare si pasojë e pandemisë dhe humbjes së tregjeve në vendet evropiane, po ashtu edhe si pasojë e mosndarjes së një pakoje të veçantë nga qeveria



EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka bërë me dije se gjendja e eksportuesve të Kosovës është vështirësuar për shkak të pandemisë, por edhe të mosndihmës së veçantë në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike për eksportuesit e vendit.

Hasani në një bisedë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se qeveria nuk ka ndarë asnjë fond të veçantë për eksporte

gjë që, sipas tij, kjo ka vështirësuar gjendjen e këtij sektori. "Gjendja e eksportuesve të Kosovës është e rëndë dhe kemi përkeqësimit të gjendjes. Kemi shumë kompani të cilat i kanë humbur tregjet. Është fatkeqësi edhe më e madhe që qeveria nuk ka ndarë asnjë fonde për eksporte. Çfarë ata kanë ndarë, janë ndihmat për sektorin e gastronomisë dhe për eksport, kurse për eksportuesit nuk është ndarë dhe nuk është paraparë asnjë fond. Ka kompani të cilat i kanë humbur tregjet, ndërkaq rikthimin do

ta kenë shumë të vështirë, sepse prodhuesit nuk kanë mundur të prodhojnë çfarë është kërkuar. Kjo është problem në vete", ka thënë Hasani.

Ai ka shtuar se, pavarësisht që kanë bërë kërkesë që në kuadër

të pakos për rimëkëmbje ekonomike të dedikohet një fond i veçantë për ta, kjo kërkesë nuk është përfillur. "Shoqata jonë ka rreth 100 anëtarë. Të gjitha kompani prodhuese. Kemi kërkuar dhe kemi dërguar shkresa gjatë

programit të rimëkëmbjes dhe nuk kemi qenë të ftuar në asnjë debat, për dallim nga pakot fiskale më parë kur kemi pasur ftesë për pakon e rimëkëmbjes", ka thënë Nexhat Hasani, kryetar i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës.

KRU 'Prishtina': Uji është i pijshëm, shfrytëzojeni në mënyrë racionale

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar se pas reshjeve të shiut gjatë ditëve të fundit, uji vazhdon të mbetet i pijshëm. Sipas KRU "Prishtina", për shkak të ngadalësimit të procesit për trajtimin e ujit, është zvogëluar kapaciteti prodhues. "Duke pasur parasysh shqetësimet e ngritura për cilësinë e ujit për pije, si rezultat i reshjeve të dendura të shiut, IKShPK/QU ka sforcuar monitorim e cilësisë së ujit për pije gjatë kësaj periudhe. Bazuar në rezultatet nga matjet e kryera deri më tash, cilësia e ujit për pije është brenda standardeve të parapara me UA 16/2012 - cilësia e ujit për konsum nga njeriu. Vlera e shtuar e turbullirës ndikon në procesin e ngadalësimit të trajtimit të ujit dhe rrjedhimisht



zvogëlimin e kapacitetit prodhues (zvogëlimi i sasisë së ujit të përpunuar), andaj

kompanitë për arsye të pamundësisë së prodhimit me kapacitet të plotë janë të

detyruar të aplikojnë restriksione/reduktime me orar të caktuar", thuhet në njoftimin

e kompanisë KRU "Prishtina". Kjo kompani ka apeluar që uji i pijshëm të shfrytëzohet në mënyrë racionale. "Në këtë situatë, qytetarët duke dashur që të kenë furnizim 24 orë me ujë, detyrohen të gjejnë alternativa për furnizim nga burimet e tjera të ujit. Bunarët/puset janë të pambrojtura, të pamenaxhuara dhe me rrezik të lartë për kontaminim. Andaj, luten qytetarët të kenë kujdes në shfrytëzimin racional të ujit dhe kursimin e tij si dhe në maksimum të kenë kujdes për shfrytëzimin dhe futjen e ujit në rrjet nga bunarët- puset, për arsye se cilësia e ujit në këto resurse është jo e sigurt e posaçërisht për shkak të turbullirës. Futja e këtij ujit do të ndikojë në ndotjen e rrjetit dhe do të reflektojë në cilësi", është theksuar në njoftimin e KRU "Prishtina".

Dogana për një muaj mbledh mbi 80 milionë euro

Prishtinë, 2 shkurt (ER) - Dogana e Kosovës ka rritur performancën e të hyrave duke tejkaluar vitin 2020 për mbi 9 për qind. "Mbledhja e të hyrave gjatë janarit të këtij viti ka

shënuar rritje e cila, nëse krahasohet me vitin e kaluar, tregon qartë se performanca e Doganës ka shënuar rritje. Gjatë janarit 2020 ne kishim grumbulluar 73,2 milionë euro derisa

raporti i këtij viti tregon 80,1 milionë euro apo 9.3 për qind më shumë", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës. Sipas Doganës, kjo rritje është domethënëse pasi janari i

vitit të kaluar (2020) ishte muaji i vetëm i vitit i cili ishte pa ndikimin ekonomik të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Prandaj, sipas këtij njoftimi, edhe kjo arritje tregon përkushtimin e



Doganës për t'i realizuar planifikimet financiare.

15 nxënës të shkollës 'Nexhmedin Nixha' në Gjakovë, përfitues të projektit RYCO

GJAKOVË, 2 SHKURT (ER) - 15 nxënës të Shkollës së Mesme Teknike "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë janë përfitues të një projekti të përbashkët, të zhvilluar në mes të nxënësve nga tri qytete të ndryshme të shteteve të Ballkanit, Gjakovës në Kosovë, Bajram Currit në Shqipëri dhe Shtipit në Maqedoninë e Veriut. Ky projekt që është financuar nga Regional Youth Cooperation Office (RYCO) dhe është implementuar nga "Let's Do It Peja" nga Kosova, Shoqata "Alpin" nga Shqipëria dhe "Youth on Board" nga

Maqedonia e Veriut, si qëllim parësor ka pasur që përmes trajnimeve dhe ndarjes së përvojave të 45 nxënësve nga të tri shtetet të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e nxënësve të shkollave të mesme për bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkulturor në disa tema të ndryshme. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, pjesë zbatimëse e tërë organizimit ka qenë edhe punimi i një murali me motive mjedisore, i realizuar në të tri qytetet pjesëmarrëse në këtë aktivitet.



Haksuka e Power diskutojnë për projektin "INCLUDE"



PRIZREN, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haksuka, ka pritur në takim shefin e Zyrës së Këshillit Evropian në Prishtinë, Frank Power, me të cilin ka biseduar për projektet e përbashkëta, veçanërisht për projektin "INCLUDE", i cili ka për qëllim t'i ndihmojë grupet e cenuara për qasje në

arsim cilësor parafillor, fillor dhe të mesëm. Përveç kësaj, të martën kryetari Haksuka ishte panelist edhe në konferencën e organizuar nga UNDP Kosovo lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Kosovë. Gjatë këtij paneli, ku u diskutua lidhur me efektet e

pandemisë në turizëm dhe ekonomi, kryetari Haksuka ka paraqitur aktivitetet e Komunës së Prizrenit për uljen e pasojave të pandemisë në sektorin e turizmit, si dhe aktivitetet e realizuara pas aprovimit të strategjisë së turizmit, 80 për qind e së cilës tanimë është zbatuar.

Memorandum mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe fshatit Zhegoc të Gjilanit

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Ministria e Mbrojtjes dhe fshati Zhegoc i Komunës së Gjilanit kanë nënshkruar të martën memorandum mirëkuptimi. Ky memorandum është nënshkruar në mes të sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe përfaqësuesit të fshatit Zhegoc të Gjilanit, invalid i luftës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe nënoficer i

pensionuar i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), Fadil Rashiti. Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes/FSK-së dhe fshatit Zhegoc ka për qëllim bashkëpunimin e palëve për shfrytëzimin e hapësirave tokësore të fshatit për realizimin e trajnimeve nga Forca e Sigurisë së Kosovës, në afat prej tre vjetëve pa kompensim financiar dhe material.



Propozohet vendimi për ndarjen e subvencioneve për sektorin e bujqësisë në Ferizaj

FERIZAJ, 2 SHKURT (ER) - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Krtistina Gashi-Bytyqi, këtë të martë ka mbajtur mbledhjen e parë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Në këtë mbledhje është diskutuar për zëvendësimin e një anëtari të komitetit për komunitete, por edhe propozimvendimi për orarin e mbledhjeve të Kuvendit të komunës. Ndërkaq drejtori i Bujqësisë, Burim Bajrami, ka bërë propozimvendimin për

ndarjen e subvencioneve në lëmin e bujqësisë. Drejtorja e Administratës së Përgjithshme, Aurora Ramadani, ka bërë propozimvendimin për daljen në diskutim publik të Draft Rregullores së Transparencës. Sipas saj, është bërë ndryshimi i udhëzimit administrativ të transparencës dhe rregullorja është dashur të harmonizohet me udhëzimin e ri administrativ. Nga ana tjetër, edhe drejtori i Pronës, Sabri Murseli, ka bërë propozimvendimin për



shpalljen e interesit të përgjithshëm të disa ngastrave kadastrale në Prelez të Jerlive,

Pleshinë dhe në Komogllave. Ai, po ashtu, ka bërë propozimvendimin edhe për

dhënie në shfrytëzim të ngastrës kadastrale 3273-0 në zonën kadastrale në Ferizaj.

Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (17)

Pas nëntë viteve lënda e Paraqinit është dëshmuar se ka qenë montim



Lulzim SAHITI

Zbardhja e së vërtetës për dhe rreth çështjes së rastit të Paraqinit ka vazhduar edhe pas nëntë viteve gjë që është dëshmuar se Procesi i Paraqinit ka qenë një nga proceset gjyqësore më skandaloze jo vetëm të asaj kohe por edhe sot e kësaj dite. Do të mbahet mend gjithmonë si një ndër proceset e inskenuara dhe më enigmatike sepse kemi të bëjmë me një proces krejtësisht të montuar politik, fund e krye të konstruktuar me perfiditetin ushtarak të KOS-it jugosllavë. Procesi i Paraqinit ishte vërtet i tmerrshëm dhe me pasoja të rënda për të dënuarit dhe familjarët e tyre. Përndryshe në histori procesi gjyqësor për rastin e Paraqinit do të jetë turpi më i madh i Shekullit XX. Për të dëshmuar se të akuzuarit janë dënuar pa asnjë faj, po publikojmë si dëshmi letrën e ish-gjyqtarit referues dr Jovan Lj. Buturoviq, i cili ishte pjesë përbërëse e kolegjit të Gjyqit Suprem Ushtarak në Beograd që kishte dënuar ushtarët e pafajshëm me dënime drakonike. Me këtë letër, Buturoviq, i ishte drejtuar: Prokurorit Suprem Ushtarak, Beograd

Më 9 dhjetor 1996 Budimir Gjorgjiq, kolonel në pension, ish prokuror ushtarak në Sarajevë, Avokat pranë Gjorgje Dozetos, ish gjykatësit të Gjykatës Ushtarake në Beograd, tani avokat, para meje ka deklaruar si vijon: Procesi në të ashtuquajturën Lëndë e Paraqinit ka qenë i montuar. Organet e sigurisë ushtarake nga Nishi kanë nxjerrë nën presion nga të akuzuarit pranim fajësie të rrejshme. Deklaratat e rrejshme mbi fajësinë e të dënuarve janë nxjerrë edhe nga dëshmitarët. N-Budimir Gjorgjiq e ka ditur këtë gjatë gjykimit, dhe këtë e ka kuptuar nga organi i sigurisë ushtarake gjatë kohës së gjykimit. Ai e ka të qartë edhe mënyrën se si organet e sigurisë ushtarake me detyrim kanë nxjerrë pranime të rrejshme nga persona të gjykar dhe deklarata të rrejshme nga dëshmitarët e intervistuar. Budimir Gjorgjiq shumë vite (thotë 16 vite) ka punuar në organet e sigurisë. Pastaj ka vazhduar me këtë bashkëpunim edhe deri sa ka punuar në Gjykatën ushtarake edhe deri sa ka qenë në detyrë të prokurorit ushtarak në Sarajevë. Tani mbanë

lidhjen me organe të ndryshme në drejtorinë e sigurimit dhe këtë nuk e fshehë, madje, edhe në gjykimin e Velko Miliqit dhe të tjerëve ka folur për këtë. Ai ka shprehur habinë kur i kam thënë se për herë të parë po dëgjoj se e ashtuquajtura Lëndë e Paraqinit është e montuar. Pastaj, më 10 dhjetor 1996 e kam pyetur se a është i gatshëm që deklaratën nga dita e mëparshme ta përsërisë në vendin e caktuar. Ka thënë se është i gatshëm.

Si gjykatës i Gjykatës Supreme Ushtarake kam qenë anëtar i Këshillit, i cili në shkallën e dytë ka vendosur për ankesat në aktgjykimin e Gjykatës Ushtarake në Nish për të ashtuquajturën Lëndë e Paraqinit. Njëkohësisht kam qenë gjykatës raportues për këtë lëndë. Normalisht që kam marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe kam qenë për aktgjykimin që është marrë. Për nxjerrjen nën dhunë të fakteve as tani dhe as më vonë, deri më 9 dhjetor 1996, nuk kam ditur asgjë por as në shkresat e lëndës nuk ka asnjë gjurmë të tillë.

Në bazë të asaj që u deklarua ekziston dyshimi se të gjykuarit janë njerëz të pafajshëm, të cilët nuk kanë kryer kurrfarë vepra kriminale për të cilat janë gjykuar. Për këtë arsye propozoj që të paraqitni kërkesën e përsëritjes së procedurës penale ose këtë t'i urdhëroni gjykatësit më të ulët kompetent ushtarak. Konsideroj që për çdo rast duhet të bëhet ekspertiza sipas nenit 407, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Penale dhe të dëgjojnë të gjithë personat, të cilët në çfarëdo forme kanë marrë pjesë në procedurën penale si dhe personat e tjerë në çfarëdo forme mund të ofrojnë çfarëdo informate e veçmas personat nga Drejtoria e sigurisë së atëhershme e APJ-së, sektorët e sigurisë nga sektorët e atëhershme të sigurisë të komandës së II A, pastaj personat që në atë kohë kanë punuar në burgun hetimor të Gjykatës Ushtarake në Nish, mjekët që i kanë vizituar personat etj.

Theksoj që në atë kohë udhëheqësi i Departamentit të Sigurisë i komandës II A, ka qenë



Aziz Kelmendi

koloneli dhe tani gjeneral nënkolonel Geza Farkosh. Theksoj se në atë kohë ka qenë e krijuar atmosferë linçuese në mjetet e informimit në RSFJ dhe se nga ana e kreut të ushtrisë së APJ-së dhe kreu i RSFJ-së është kërkuar që me çdo çmim të zbulohen dhe të dënohen fajtorët për masakrën në kazermën e Paraqinit. Ju lutem që për këtë iniciativë timen të deklarojeni dhe të merrni vendim konform ligjit.

Dr Jovan Lj. Buturoviq, rruga "Jurija Gagarina" 174/39, Novi Beograd (E përktheu nga origjinali, Ibrahim Demiri)

"Nasha Borba" - Dëshmi e re për rastin e vrasjes në kazermën e Paraqinit: "Procesi ka qenë i montuar"

Ish-prokurori ushtarak në Sarajevë ka deklaruar se procesi në Lëndën e Paraqinit ka qenë i montuar, ndërsa avokati Jovan Buturoviq i është drejtuar prokurorit suprem ushtarak që të paraqesë kërkesë për përsëritjen e procedurës penale.




Deklarata e kolonelit në pension, ish prokurorit ushtarak në Sarajevë se procesi në Lëndën e Paraqinit ka qenë i montuar është shkas i shkresës së avokatit dr. Jovan Buturoviqit prokurorit suprem ushtarak që të paraqesë kërkesën për përsëritjen e procedurës penale. Rikujtojmë se kemi të


bëjmë me vrasjen e 4 dhe plagosjen e 6 ushtarëve në kazermën e Paraqinit 1988, vepër e kryer nga Aziz Kelmendi, pas të cilës, siç është raportuar, ka bërë vetëvrasje. Pas kësaj janë dënuar 8 shqiptarë, kinse bashkëpunues të marrës, me dënim burgimi nga 4 deri në 20 vjet. Avokati dr. Buturoviq, i cili në atë kohë ishte gjyqtar raportues në shkallën e dytë, pasi ka arritur deri te njohuritë e reja, ka vendosur që t'i drejtohet prokurorit suprem ushtarak. Në këtë letër ai së pari citon deklaratën e këtij dëshmitari shtesë (i cili ka dashur të jetë anonim për shkak se procedura ishte duke u zhvilluar): Procesi në të ashtuquajturën Lëndë e Paraqinit ka qenë i montuar. Organet ushtarake të sigurisë nga Nishi me detyrim kanë nxjerrë nga të dënuarit pranimin e fajit. Pranimi me detyrim për fajësinë e të dënuarve është nxjerrë edhe nga dëshmitarët.

Dr. Buturoviq deklaroi se koloneli vet ka pasur njohuri për këtë gjë edhe gjatë gjykimit dhe se këtë e ka kuptuar nga organet ushtarake të sigurisë. Atij i ishte bërë e qartë edhe mënyra se si organet ushtarake të sigurisë kanë nxjerrë me detyrim pranimin e rrejshëm nga të dënuarit dhe deklaratat e rrejshme të dëshmitarëve të intervistuar. Ky kolonel shkruan, dr. Buturoviq, ka theksuar se gjithashtu ka punuar 16 vite në organet e sigurisë dhe se me këtë bashkëpunim ka vazhduar edhe deri sa ka punuar në prokurorinë ushtarake madje dhe në detyrën e prokurorit ushtarak në Sarajevë dhe se edhe tani mban lidhjen me organet e caktuara në drejtorinë e sigurisë duke mos e fshehur këtë. "ai ka shprehur habinë", thekson avokati Buturoviq, "kur unë i kam thënë se për herë të parë po dëgjoj për të ashtuquajturin proces të montuar të Paraqinit. Më pas, saktë më 10 dhjetor 1996 e kam pyetur se a është i gatshëm që këto dëshmi t'i përsërisë në vendin e caktuar. Ka thënë se është i gatshëm". "si gjykatës i gjykatës supreme ushtarake kam qenë anëtar i këshillit, i cili në shkallën e dytë ka vendosur për ankesat ndaj aktgjyqimeve të Gjykatës Ushtarake në Nish për të

ashtuquajturën Lëndë e Paraqinit", shkruan Jovan Buturoviq. "njëkohësisht kam qenë gjyqtar raportues në këtë lëndë. Normalisht që kam marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe kam qenë për aktgjykimin që është marrë. Për nxjerrjen nën dhunë të fakteve as tani dhe as më vonë, deri në dhjetor të vitit të kaluar, nuk kam ditur asgjë por as në shkresat e lëndës nuk ka asnjë gjurmë të tillë". "Duke marrë parasysh këtë që u tha" avokati Buturoviq i bëhë me dije prokurorit suprem ushtarak se "ekziston dyshimi i bazuar se të dënuarit janë njerëz të pafajshëm, të cilët nuk kanë bërë vepra penale, vepra për të cilat janë dënuar. Për këtë propozoj që të paraqitni kërkesën për përsëritjen e procedurës penale ose t'i urdhëroni prokurorisë më të ulët kompetente ushtarake një gjë të tillë. Konsideroj që në çdo rast duhet të bëhet ekspertiza sipas nenit 407 paragrafi 2 i Ligjit për procedurën penale dhe të dëgjojnë të gjithë personat që në çfarëdo forme kanë marrë pjesë në procedurën paraprake penale si dhe të tjerët të cilët mund të ofrojnë çfarëdo informata. E veçmas personat nga drejtoria e atëhershme e sigurisë së APJ, sektorit të sigurisë të komandës së atëhershme II A, pastaj personat që në atë kohë kanë punuar në burgun hetues, të Gjyqit Ushtarak në Nish, mjekët që kanë vizituar të burgosurit etj. Theksoj që në atë kohë drejtori i repartit të sigurisë pranë kësaj komande ka qenë koloneli e tani gjeneral nënkolonel Geza Farkash.

Në fund dr. Jovan Buturoviq thekson: "rikujtoj që në atë kohë u krijuar atmosfera linçuese në mjetet e informimit në RSFJ dhe që nga ana e kreut ushtarak të APJ-së dhe kreu shtetëror i RSFJ-së është kërkuar që me çdo çmim të zbulohen dhe të dënohen fajtorët për masakrën në kazermën e Paraqinit". Këtë shkresë prokurorit suprem ushtarak, dr. Buturoviq, i ka drejtuar më 6 janar të këtij viti. Deri tani përgjigje nuk ka. B.O. Iliq "Nasha Borba", më 9. 5. 1987, fq. 17 (E përktheu nga origjinali, Ibrahim Demiri) VIJON





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Nuk lejohen shikuesit në 'Final 8'



PRISHTINË, 2 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se pavarësisht prej insistimit të madh nga ana e saj te Ministria e Shëndetësisë (MSh) në "Final 8" të Kupës së Kosovës në basketboll, që do të zhvillohet nga 3 deri më 7 shkurt në Suharekë, nuk do të lejohen shikuesit dhe do të respektohet vendimi i Qeverisë së Kosovës që në palestër duhet të jenë maksimumi 50 persona, duke përfshirë këtu lojtarët, trajnerët, gjyqtarët, zyrtarët e ndeshjes dhe zyrtarët e FBK-së.

Federata e Basketbollit e Kosovës ka kërkuar dhe ka insistuar te Ministria e Shëndetësisë disa herë që të lejohen të paktën 200 shikues, të cilët do t'oheshtojnë masat, si distancën fizike dhe bartjen e maskës, megjithatë vendimi nga MSh-ja nuk ka ndryshuar. "Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) edhe një herë kërkon nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) lejimin e shikuesve (200 në total) në ndeshjet e Final 8 Kupës së Kosovës, ngjarje kjo që do të organizohet prej 3 deri më 7 shkurt 2021 në palestrën e sportit "13 Qershori" në Suharekë. Federata e

Basketbollit e Kosovës rithekson se është e gatshme që së bashku me organizatorin e Final 8 Kupës së Kosovës, Klubin e Basketbollit Golden Eagle Ylli, ta bëjë organizimin e shikuesve, gjithnjë duke respektuar masat në fuqi për Covid-19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Udhëzuesin e FBK-së për Rikthimin në Fushat e Basketbollit dhe Protokollin e FIBA-s për Covid-19, në të cilat theksohet fuqishëm mbajtja e distancës sociale dhe e vendosjes së maskës", thuhet në kërkesën e FBK-së.

Të dielën Ministria e Shëndetësisë ka treguar se do të lejohen vetëm 50 persona gjatë aktivitetëve në palestra. "Referuar e-mailit tuaj, ju informojmë që aktivitetet mund të realizohen gjithmonë duke respektuar vendimet e lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe manualin për mbrojtje nga Covid-19", thuhet në përgjigjen nga MSh, që i referohet vendimit të mëparshëm me numër 09/58 të datës 14.01.2021, gjegjësisht pikës 24 të vendimit - Masat për aktivitetet publike. Federata e Basketbollit e Kosovës sërish ka kërkuar që të lejohen tifozët, por përgjigja e prerë ka arritur sërish

të martën (sot). "Nga QOE/MSH më parë keni pranuar përgjigjen në kërkesën tuaj. Ju rikujtojmë që nuk ka ndryshime nga Vendimin nr. 09/58 datë 14.01.2021, që nënkupton se shprehimisht është e rregulluar lejimi i këtyre aktivitetëve dhe pjesëmarrja e mundshme e personave në këto aktivitete". Vendimi për lejimin e aktivitetëve sportive në palestra është ky: "Në hapësira të mbyllura ndalohet grumbullimi i qytetarëve në numër prej më shumë se 30 personave, ndërsa në sheshe publike, parqe, vende publike, qendra rekreative dimërore dhe të ngjashme, lejohet grumbullimi deri në 50 persona me përjashtim të rasteve të lejuara me këtë vendim".

Federata e Basketbollit e Kosovës, në bashkëpunim me klubin organizator Golden Eagle Ylli, do të bëjë çmos që këto rregulla të respektohen dhe të mos ketë probleme. Rrjedhimisht edhe mediat nuk do të lejohen në palestër, megjithatë Federata e Basketbollit e Kosovës do të përkujdeset që të ofrojë statistikën 'LIVE' në faqen zyrtare, raportet e ndeshjeve, fotografitë, "Highlights" dhe deklaratat pas ndeshjes.

SHKURT

FC Prishtina rikthehet në Kosovë

Ekspedita e Prishtinës të hënën në mbrëmje është rikthyer në Kosovë pas 14 ditëve të fazës përgatitore në Turqi. Klubi prishtinas në faqen zyrtare ka njoftuar se trajneri u ka dhënë futbollistëve dy ditë pushim. "Kryetrajneri Ramadani i ka dhënë ekipit pushim dyditor, ndërsa u rikthehet seancave stërvitore të enjten. Gëzon fakti që gjatë qëndrimit në Antalya nuk ka futbollistë të lënduar dhe skuadra po gëzon formë optimale fizike", thuhet në njoftimin e skuadrës "bardhekaltër". Prishtina, po ashtu, ka njoftuar se në ditën e fundit të afatit kalimtar sulmuesi Dhurim Zhuri është huazuar në Besë të Pejës.

Kameri rikthehet në Skoci

Futbollisti shqiptar Florian Kamberi i është bashkuar Aberdeen Football Club. Ai së fundmi ishte pjesë e St Gallenit në Superligën e Zvicrës, derisa ka luajtur edhe për Rangers, por që nuk ia ka dalë të lë gjurmë. Në Skoci, Kamberi shpreson të nisë me këmbë të mbarë dhe t'i tregojë atësitë prej sulmuesi.

Mustafi lë Arsenalin, shkon te Schalke

Shkodran Mustafi është larguar pas katër sezonesh e gjysmë qëndrim në Londër me Arsenalin. Minutat për të ishin të pakta në dispozicion dhe vendosi të largohet nga klubi, që në vitin 2016 e bleu 41 milionë euro nga Valencia. Kështu, Mustafi kthehet në Gjermani pas plot 11 vjetësh kur kishte luajtur në Akademinë e Hamburgut. 28-vjeçari shkon te Schalke me parametra zero, pasi mbylli kontratën me Arsenalin 6 muaj para përfundimit të saj. Në kalimin e tij te klubi gjerman Mustafi ka firmosur kontratë deri në fund të sezonit. Ai do të përpiqet ta ndihmojë Schalken për të mos rënë nga Bundesliga këtë sezon, teksa aktualisht renditet në vendin e fundit në renditje. Dardani zëvendëson turkun Ozan Kabak, i cili mbrëmjen e djeshme u zyrtarizua te Liverpooli.

Bashkimi përballë Prishtinës në finalen e Kupës

Java e parë e muajit shkurt do të karakterizohet me garat në "Final 8" të Kupës së Kosovës Vllasa & Pagesa. Të dielën nga ora 14:00 do të zhvillohet finalja në mes të Bashkimit dhe Prishtinës në konkurrencën e femrave. Prizrenaset kanë mundur Penzën në gjysmëfinale, kurse prishtinaset kanë eliminuar Vëllaznimin. Bashkimi dhe Prishtina ishin përballur edhe në finalen e Kupës të edicionit të kaluar, ku triumfuan vashat nga Prizreni, ashtu siç triumfuan edhe në Superkupë. Sa i përket formës në këtë edicion, Bashkimi ka 11 fitore dhe një humbje në Superligë, derisa Prishtina tetë fitore dhe katër humbje. Përballjet ndërmjet këtyre dy skuadrave në vitet e fundit kanë qenë shumë interesante, pasi të dyja skuadrat kanë luftuar për trofetë e basketbollit të Kosovës. Bashkimi ka fituar pesë herë trofeun e Kupën, kurse Prishtina 11 herë, duke përfshirë edhe trofetë me Universitetin e Prishtinës. Të dyja skuadrat kanë bërë ndryshime në këtë edicion dhe me përforcimet, përballja e së dielës pritet të jetë shumë interesante.

Francezi Anthony Monin përforcon Llapin

PODUJEVË, 2 SHKURT - Skuadra e Llapit ka arritur marrëveshje dyvjeçare me qendërmbrojtësin francez Anthony Monin i cili nga dita e martë është bashkuar me skuadrën, ndërsa ka pasur

edhe disa minuta në ndeshjen kontrolluese ndaj Bashkimit. 24-vjeçari ka lindur në Besancon të Francës. Pozita e tij natyrale është qendërmbrojtës dhe ka bërë karrierë te skuadrat e FC

Vesoul, Caledonian Braves FC, Berwick Rangers FC U20 dhe, së fundmi, te FC Vallorbe-Ballaigues. "Klubi ka k o m p l e t u a r dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e

futbollistit para arritjes në Kosovë dhe Anthony Monin ka të drejtë loje që nga ndeshja e parë për Kupë ndaj Ballkanit që pritet të zhvillohet më 10 shkurt", thuhet në njoftimin e Llapit.



Mick Schumacher: Ky është trofeu më i rëndësishëm i babait tim që kam

Berlin, 2 shkurt - Mick Schumacheri përgatitet për debutimin e tij në Formula 1 me makinën amerikane Haas. Javën e kaluar ai ka zhvilluar disa teste me Ferrari 2018, për t'u ambientuar sa më shumë

me njëvendëset e Formula 1. Piloti i ri gjerman shpreson ta vijojë dinastinë Schumacher, duke ndjekur gjurmët e babait të tij, legjendës Michael Schumacher. Mick u shpreh se ka një marrëdhënie shumë të

ngushtë me babanë e tij që prej vitesh është në fazë rehabilitimi pas aksidentit. Mick shpreh se një trofe i babait të tij e mban gjithnjë me vete. "Është një kupë e vogël që më ka bërë dhuratë babai im, pasi kishte

fituar një garë 'kart'. E kam me vete që kur isha -vjeç dhe është gjithnjë në një vend të dukshëm në dhomën time. Ky është trofeu më i rëndësishëm i babait tim që kam", ka deklaruar Mick Schumacher.



Ndeshjet çerekfinale pritet të dhurojnë spektakël të basketbollit



PRISHTINË, 2 SHKURT - Sot (mërkurë) fillojnë çerekfinale të "Final 8" të Kupës së Kosovës #VllesaPagesa. Në fakt, ndeshja e parë do të jetë ndërmjet Istogut dhe RC Cola Dritës, takimi gjysmëfinal i Kupës së Ligës së Parë. Takimi i parë i çerekfinale është ndërmjet Rahovecit dhe Trepçës, dy skuadra që e duan trofeun e çmuar në basketbollin e Kosovës. Vreshtarët së fundi janë përforcuar me Altin Morinën

dhe Arian Qallakun, kurse rikthimi i Drilon Hajrizit ka ringjallur mitrovicasit që kanë rritur edhe ambiciet në këtë edicion. Pas kësaj ndeshje do të bëhet edhe hapja solemne me një ceremoni të organizuar. Sfida e dytë çerekfinale do të jetë mes Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit. Therandastit janë përforcuar me Gëzim Morinën dhe Erjon Kastratit, duke pasur një ekip shumë të komponuar, kurse Bashkimi gjithmonë ka

aspirata të mëdha. Fituesit e këtyre dy ndeshjeve do të përballen në gjysmëfinale. Ndeshjet do të zhvillohen në palestrën "13 Qershori" në Therandë, ku do të zhvillohen të gjitha takimet e "Final 8".

Të mërkurën takohen:

13:00 Istogu - RC Cola Drita
16:00 Grupi B: Rahoveci - Trepça
18:30 Hapja solemne
19:00 Grupi C: Golden Eagle Ylli - Bashkimi

Ademi kërkon nga Zemaj rikthimin e shikuesve për kualifikueset e Botërorit 2022

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të martën priti në takim Ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, ku të pranishëm ishin edhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, Xhelal Broja dhe drejtuesit e tifo grupit "Dardanët", Lulzim Berisha e Lik Berisha. Ministri Zemaj shprehu mirënjohje për punën e mirë që po bën FFK-ja në krye me Ademin dhe e falënderoi atë për menaxhimin e mirë të situatës me pandeminë dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve gjatë kësaj periudhe. Në anën tjetër, kryetari Ademi, po ashtu, e falënderoi ministrin Zemaj për kontributin e tij në kohën e pandemisë dhe mbështetjen që i dha futbollit me të gjitha institucionet shëndetësore. "Takimi ishte i fokusuar për gjetjen e mundësisë së rikthimit të tifozëve në numër të shkurtuar në stadium për



ndeshjet kualifikuese të Botërorit 2022 që nisin në mars, në mënyrë që Përfaqësuesja ta ndjejë sadopak atmosferën që dinë ta krijojnë tifozët 'Dardanët'. Kreu i FFK-së i kërkoi ministrin Zemaj ta shqyrtojë mundësinë e rikthimit të tifozëve në stadium me institucionet e

tjera relevante. Rreth kësaj çështje ministri Zemaj ka thënë se do të veprohet varësisht nga situata, teksa kërkoi një model nga vendet evropiane, që ka qenë funksional dhe i cili do të mund të aplikohet edhe në Kosovë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

SHKURT

Neymari: Jam i lumtur në PSG, nuk largohem

Futbollisti i Paris Saint Germainit, Neymar, ka folur pas humbjes së djeshme që skuadra e tij e pësoi në kuadër të xhiros së 22-të të Ligës 1 nga Lorienti. Neymari shënoi dy gola në këtë ndeshje, por nuk i mjaftuan skuadrës që t'i arketojë pikët. Neymari, duke folur për "TF1", u shpreh i lumtur që është pjesë e PSG-së dhe shpreson që edhe Mbappe të qëndrojë. "Jam shumë i lumtur këtu, ndihem mirë dhe jam adoptuar, jam i qetë. Jam i lumtur dhe dua të mbes këtu në PSG. Shpresoj që edhe Kilyan Mbappe të qëndrojë. Natyrisht kjo është dëshira e tifozëve dhe duam që PSG të mbesë një skuadër e madhe. Dëshirojmë të vazhdojmë kështu dhe ta japim maksimumin për klubin", ka thënë Neymari.

Griezmann: Messi është një legjendë

Antoine Griezmann e ka lavdëruar Lionel Messin pasi detajet e fitimeve të tij në Barcelona u zbuluan një natë para ndeshjes kundër Athletic Bilbaos. Sulmuesi francez ka thënë se Messi është një legjendë. "Ne jemi duke shijuar Leo Messin. Ai është një legjendë", ka thënë Griezmann. Griezmanni dhe Messi ishin golashënues në ndeshjen që Barcelona e fitoi të dielën kundër Athletic Bilbaos (2-1).

Tosuni huazohet te Beshiktashi

Sulmuesi Cenk Tosun e ka kompletuar kalimin nga Evertoni te Beshiktashi në formë huazimi deri në fund të sezonit. Tosuni në vitin 2018 ishte transferuar te skuadra e Evertonit nga Beshiktashi për 27 milionë euro, por nuk ka arritur asnjëherë të dëshmojë dhe ishte i huazuar edhe në Crystal Palace. Repreruesi turk ka luajtur edhe për Gaziantepsporin dhe Eintracht Frankfurtit.

Piloti i Formulës 1 infektohet me Covid

Piloti francez Pierre Gasly, që garon në Formula 1 me makinën Alpha Tauri, ka konfirmuar se ka dalë pozitiv me koronavirus. Ai e dha lajmin përmes një postimi në rrjetet sociale, duke shtuar se ndihet mirë. "Përhëndetje të gjithëve! Uroj të jeni të gjithë mirë e të sigurt. Dua të ndaj me ju lajmin se kam rezultuar pozitiv me Covid-19. Kam informuar këdo që ka qenë në kontakt me mua ditët e fundit. Jam izoluar menjëherë dhe po ndjek procedurat e sigurisë që kanë vendosur autoritetet shëndetësore. Do ta vijoj stërvitjen në shtëpi gjatë kësaj kohe që jam në karantinë", ka shkruar Gasly, i cili është piloti i gjashtë në Formula 1 që infektohet me koronavirus.

Pensionohet Afellay

U trumbetua me të madhe se do të ishte një nga talentet më premtues të futbollit, por Ibrahim Afellay nuk arriti të ngrihej kurrë në nivelin e pretenduar. I pafat edhe për shkak të dëmtimeve, holandezi ka vendosur së fundmi, në moshë 34-vjeçare, t'i varë "këpucët në gozhdë", duke hequr dorë nga futbollit i luajtur. Afellay debutoi në vitin 2004 në PSV, teksa më pas bëri transferimin e jetës duke kaluar te Barcelona por, për fat të keq, rezultoi një zhgënjim. Me katalanasit mesfushori u aktivizua 21 ndeshje dhe shënoi vetëm një gol. Më pas holandezi u huazua te Schalke dhe Olimpiacos, por pa mundur të lërë gjurmë. Stoke dhe PSV ishin dy destinacionet e fundit në karrierën e tij. Prej muajit qershor ishte pa skuadër, teksa tashmë vendosi të tërhiqej përfundimisht. 34-vjeçari arriti të fitonte disa trofe, ndër kohë që regjistroi edhe 53 paraqitje me Kombëtaren A të Holandës.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €




DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE


Bilanci i gjendjes me : 31.12.2020 Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	7,687.99	8,960.24
Kërkesat ndaj bankave	683.36	1,023.79
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	7,011.16	6,864.98
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	49,466.92	56,416.39
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,147.75	1,838.46
Pasuritë e paprekshme	227.69	278.29
Pasuritë tatimore të shtyra	187.02	187.02
Pasuritë tjera	80.82	282.73
Gjithsej pasuritë	66,492.69	75,851.89
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	43,391.67	56,754.53
Detyrimet ndaj bankave	9,212.55	4,188.58
Fondet tjera të huazuara	4,550.71	4,552.72
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	592.78	1,350.23
Gjithsej detyrimet	57,747.71	66,846.06
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000.00	10,000.00
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprak	2,177.05	2,177.05
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	757.55	1,018.42
Përbërësit tjerë të ekuitetit	164.48	164.46
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	8,744.98	9,005.83
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti	66,492.69	75,851.89

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31.12.2020 Euro'000


	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	2,441.10	3,371.07
Shpenzimet e interesit	789.36	1,080.46
Neto të hyrat nga interesi	1,651.74	2,290.61
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	492.43	608.83
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	117.87	145.14
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	374.56	463.69
Neto të hyrat nga tregtimi	9.78	12.60
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	1.69	1.69
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	1,228.61	1,633.88
Gjithsej të hyrat	809.16	1,134.71
Provizionet për humbjet nga kreditë	52.76	113.55
Provizionet tjera	1.15	2.74
Fitimi/(humbja) para tatimit	757.55	1,018.42
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Fitimi/(humbja) neto	757.55	1,018.42
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	757.55	1,018.42

 **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- D.P.T. "Goni Tex" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 600563028.
- Mirsad Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.
- Arben Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.
- Faik Fazliu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Faik Kornica " Arberesha Qollopeku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.
- Asip Fejza shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Ekrem Rexha Drini " Lubizhd.
- Kastriot Duraj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Matë Logoreci " Prizren.
- Nderim Gashi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Merita Kutilovci Hoxha shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

